



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Raport individual për rezultatin e konsultimit publik për Projektligjin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”

1. Titulli i projektaktit

Projektligj “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”¹

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Kohëzgjatja e konsultimeve publike ka qenë nga muaji qershor-korrik 2021 ku përmes Regjistrimit Elektronik në RENJK është realizuar nga data 07.6.2021-07.7.2021

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit të përdorura për Projektligjin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, raportohen si mëposhtë vijon:

1. Takime me grupet e interes: takime online janë zhvilluar me përfaqësues të shoqatave të biznesit dhe akademisë, me donatorë në fillim të procesit të draftimit dhe në finalizim të tij . Në fillim të procesit takimet janë zhvilluar online ndërsa në përfundim, janë zhvilluar fizikisht, me prezencën edhe të znj. Ministre të Financave dhe Ekonomisë.² Njoftimi është shpërndarë në rrugë elektronike si me email ashtu edhe në faqen zyrtare të rrjeteve sociale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me afat 30 ditë.

2. Mbledhje e mendimeve dhe sugjerimeve nëpërmjet postës elektronike si edhe shkresave pasi projektligji është dërguar për dhënie mendimi tek Ministrinë e Linjës, AIDA e AKPA me afat 15 ditë për kthyerjen e përgjigjes.

¹ Objektivat dhe rezultatet e synuara të projektaktit janë:

- Rritja e mbështetjes për NMVM-të me 50 %;
- Rritja e aplikimeve për teknologji të reja nga zero aktualisht në 50 % brenda vitit 2022.
- Rritja çdo vit e numrit të ndërmarrjeve të reja me , rritja e numrit të të punësuarve si edhe futja e instrumenteve të reja financiare me 10 %. respektivisht për cdo tregues;
- Rritja e shkallës e përthithjes së granteve me 100 % nga bizneset

² Më konkretisht: Në datën **16.06.2021**- Takim me përfaqësues të Akademisë dhe Shoqërisë Civile (Universiteti i Tiranës, UET,UBT,EPOKA,Universiteti Mesdhetar etj)

22.06.2021-Takim me Shoqatat e Biznesit (Dhoma amerikane e Tregtise, Dhoma italiane e Tregtise, Dhoma Gjermane, UCCIAL, Dhoma e Tiranës, Nordic Association etj)

28.06.2021-Takim konsultues me Keshillin e Investimeve, me pjesëmarrjen e znj, Ministre

3. Takime konsultuese si me Këshillin e Investimeve

4. Publikimi në Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike në linkun <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/355>, si edhe njoftuar në faqen zyrtare të rrjeteve sociale të MFE-së:

4. Palët e interesit të përfshira

Projektvendimi është përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në këtë proces janë 6 palë të përfshira: Shoqata biznesi, publik i gjërë, donatorë, qeveri, institucione ndërkombëtare, Akademi si: Përfaqësues të Akademisë dhe Shoqërisë Civile (Universiteti i Tiranës, UET, UBT, EPOKA, Universiteti Mesdhetar etj) 13 pjesëmarrës; Shoqatat e Biznesit (Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Italiane e Tregtisë, Dhoma Gjermane, UCCIAL, Dhoma e Tiranës, Nordic Association etj) 16 pjesëmarrës; Institucione ndërkombëtare (Banka Botërore, EBRD, UN) Ministrinë e Linjës (MEPJ, MD, MASR, Minister Shteti për Diasporën, MIE etj). Institucione të tjera (Këshilli i Investimeve)

Më konkretisht:

Projektakti u dërgua për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë për Mbështetjen e Sipërmarrjes, Ministrinë e Shtetit për Diasporën, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Njësinë e Vetqeverisjes Vendore.

Unioni i Dhomave gjithashtu ka qënë një nga palët e interesit të përfshira në proces, bashkë me Shoqatat e Biznesit.

Kontribute kanë dhënë gjatë procesit të konsultimit dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe nivel të vetëqeverisjes vendore, nëpunëset/nëpunësit e nxitjes së biznesit në MFE si edhe përfaqësues të akademisë dhe organizatat kombëtare të shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare si Eorl Bank, EBRD, UN, pra 3 palë.

1. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsytimin e komenteve të pranuar/refuzuara:

Gjithësej janë dhënë 38 komente, nga të cilat 30 janë të reflektuara, 6 të reflektuara pjesërisht dhe 2 të refuzuara, si mëposhtë vijon:

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendi mi pranuar	Justifikimi
• Vendorsja e rregullave për zbatimin e përkufizimit ligjor për SME-të	Lidhur me numrin e punonjësve në kompanitë cilësuar si SME, të jone ne perputhje me Acquis. (4 institucione kanë bërë këtë koment, si MD, KI, MEPJ dhe Shoqatat e Biznesit.	MD, KI, MEPJ, Komuniteti i biznesit	1.i pranuar	Sugjerim i pranuar, pasi ndikonte në cilesine e projektligjit duke vendosur rregulla per perkufizimin dhe për të qënë në

	<p><i>MD dhe MEPJ ka dërguar komentimin në formë shkresore,</i></p> <p><i>KI dhe Shoqatat e Biznesit në tryezat e përbashkëta që janë organizuar më 22 dhe 28 qershor 2021</i></p>			koherencë me acquis
<ul style="list-style-type: none"> Ofrimi i shërbimeve publike nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve 	<p><i>Zgjerimi i fushës së mbështetjes për bizneset</i></p>	Komuniteti i biznesit	2.i pranuar	Sugjerim i pranuar, pasi ndikon në cilesinë e projektligjit duke zgjeruar fushën e mbështetjes për bizneset
<ul style="list-style-type: none"> Përcaktimi i qartë dhe të plotë të organeve kompetente dhe detyrave përkatëse 	<p><i>Vendosja e rolit të organeve të njëjësive të vetqeverisjes vendore</i></p>	Komuniteti i biznesit	3.i pranuar	Sugjerim i pranuar pasi ndikon në cilesinë e projektligjit për përcaktimin e qartë dhe të plotë të organeve kompetente dhe detyrave përkatëse.
<ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i unifikuar I Teknikes legjislative 	<p><i>Perkufizimet e dhena në nenin 3 të projektligjit, në përputhje me rregullat e Teknikes legjislative të vendosura sipas rendit alfabetik, Në funksion të qartësimit të përmbajtjes së aktit. (16+3 sugjerime lidhur</i></p>	MD, MASR MD, MASR, MEPJ, Komuniteti i Biznesit, Keshilli i Investimeve	I pranuar	Sugjerim I pranuar pasi ndikon në cilesinë e formatit të projektaktit

	<i>me teknikën legislative shumica e të cilave rreth 15 komente janë dhënë nga Ministria e Drejtësisë në formë shkresore, ndërsa të tjerat nga MEPJ, MASR gjithashtu në formë shkresore, nga Komuniteti i Biznesit janë dhënë në takimin e zhvilluar më 22.06.2021 ndërsa nga Këshilli i Investimeve janë dërguar me email.</i>			
<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i shkalles se perafritimit me <i>acquis communautair</i> e 	<p><i>Në tabelat e përputhshmërisë sugjerohet të bëhen ndryshimet e nevojshme sipas <i>acquis</i> (5 Komente)</i></p> <p><i>janë bërë lidhur me këtë sugjerim nga MEPJ, MASR, Komuniteti i Biznesit Dhoma e Tiranës, Dhoma e Austrisë, Dhoma e Greqisë</i></p>	MEPJ Komuniteti i Biznesit Dhoma e Tiranës, Dhoma e Austrisë, Dhoma e Greqisë	I pranuar	Sugjerim i pranuar pasi ndikon në cilesinë e formatit të projektaktit
<ul style="list-style-type: none"> Ofrimi i shërbimeve publike nga Agjensia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve 	<p><i>Nga ana tjetër është e domosdoshme promovimi dhe ndërgjegjësimi i masave mbështetëse dhe skemave të mbështetjes financiare të disponueshme për ndërmarrjet-momentumi i krijuar nga prezantimi i portalit elektronik për instrumentet financiare të krijuara me fonde nga buxheti i shtetit dhe me partnerët për zhvillim (parashikim në Nenin 11 pika 7), i zhvilluar nga AIDA në bashkëpunim me BERZH. Në këtë</i></p>	Këshilli i Investimeve	Jo I pranuar	<p>Draft ligji është në linjë me parashikimet e bera nën shtyllen 2 të draft Strategjise</p> <p>Nuk ka nevojë për ndryshime në projektligj</p>

	<i>kuptim masat konkrete të realizuara të cilat duken si i kanë paraprirë projekt-ligjit janë një praktikë pozitive.</i>			
<ul style="list-style-type: none"> • Përcaktimi i detyrimeve 	<i>Plotësimin e mangësive të cilat lidhen me disa aspekte ligjore të ligjit 8927/2002 “Për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme” dhe konkretisht me përcaktimin e detyrimeve të qarta ligjore mbi menaxhimin e fondit të mbështetjes buxhetore, të cilat janë akomoduar në nenin 11, pikat 3 dhe 4.</i>	Këshilli i Investimeve	Jo i pranuar	Draft ligji është në linjë me parashikimet e bërë në shtyllen 2 të draft Strategjise Nuk ka nevojë për ndryshime në projektligj
<ul style="list-style-type: none"> • Përkufizimet 	<i>(Neni 2)-Përkufizimet janë përgjithësisht të harmonizuara me Rekomandimin e Komisionit European 2003/361/EC. - Përkufizimi (3) Shifër afarizmi është e harmonizuar edhe me kuptimin e konceptit sipas Standardit Kombëtar të Kontabilitetit (SKK 15).</i>	Këshilli i Investimeve Shoqatat e Biznesit, Dhoma e Greqisë, MEPJ Akademia, MD, MASR	I Pranuar pjesërisht	Sipas përkufizimit të dhënë në draft ligj, neni 3, gërma dh) “Fonde të zhvillimit rajonal” janë ato fonde, që sigurojnë mbështetje financiare për zhvillimin e rajoneve në fusha të caktuara, si: investimet në kapacitetet e prodhimit, ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës, investimet në fushën e kujdesit

	<p>- <i>Përkufizimi (6) Nuk është e qartë se cilat janë “rajonet” mbi të cilat bën referencë përkufizimi 6- “fonde të zhvillimit rajonal”, në një kohë që Shqipëria është e ndarë në qarqe. Nëse përkufizimi bëhet mbi bazën e “rajoneve” të përcaktuara në ndonjë ligj specifik, atëherë, pika 6 duhet të bëjë referencë në bazën përkatëse ligjore.</i></p> <p><i>(6 komente)</i></p> <p>6 komente janë bërë lidhur me komentin me siper nga KI, MD, Shoqatat e Biznesit, MASR,(Dhoma e Greqise) MEPJ dhe Akademia). Komente nga KI dhe MD janë dërguar me email dhe formë shkresore si 2 nga format e konsultimit</p>		<p>shëndetësor dhe të edukimit. Pra referenca është e dhënë me Fondin dhe është marrë sipas përkufizimit të BE-së.</p> <p>Pesë Fondet kryesore punojnë së bashku për të mbështetur zhvillimin ekonomik në të gjitha vendet e BE-së, në përputhje me objektivat e strategjisë Evropa 2020:</p> <p>Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal (ERDF)</p> <p>-Fondi Social Evropian (ESF)</p> <p>-Fondi i Kohezionit (CF)</p> <p>-Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural (EAFRD)</p> <p>-Fondi Evropian Detar dhe i Peshkimit (EMFF)</p>
--	--	--	--

	publik që janë përdorur për këtë akt (përmendur në krye të Raportit) dhe Akademia dhe shoqatat e Biznesit në takimet e datës 16 dhe 22 Qershor 2021			Në vijim të komentit, është reflektuar në draftligj duke hequr fjalën “rajone”
--	---	--	--	--

Ministri për Mbështetjen e Sipërmarrjes, Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, dhe Njësia e Vetqeverisjes Vendore janë shprehur dakord.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, dhe Ministria e Drejtësisë, janë shprehur dakord me sugjerimet përkatëse nga të cilat:

MASR: Ka dhënë 4 sugjerime, nga të cilat 3 janë reflektuar. Për sugjerimin që nuk është pranuar, është dhënë shpjegimi i nevojshëm në relacionin shpjegues;

MEPJ: Ka dhënë 4 sugjerime, të cilat janë reflektuar;

MD: Ka dhënë sugjerime të cilat janë reflektuar, shpjeguar edhe në relacionin shoqërues.

Shumica e komenteve të Ministrisë së Drejtësisë (15 komente) janë dhënë për rregullimin e teknikës legjislative si wording, renditje të neneve, pikëzim me numra jo me shkronja, etj.